



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 163, Datë 19.07.2018

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “RENRGY TRADING GROUP” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k, në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 465 datë 22.06.2017, shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 152, datë 03.07.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Pas kësaj vendimmarrje, me shkresën nr. 55/46 Prot., datë 03.07.2018, u bë njoftimi në median e shkruar si dhe me shkresën nr. 465/1 Prot., datë 11.07.2018, i’u kërkuar subjektit të plotësojë dokumentacionin e munguar.
- Subjekti “ReNRGY Trading Group” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr.465/2 Prot., datë 11.07.2018, paraqiti në ERE dokumentacionin e munguar.
- Në përfundim të afatit 10 ditë pune, të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria

“ReNRGY Trading Group” sh.p.k, për licencim ne veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, (Neni 9, pika 1). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.8). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.